

	
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Nësele:	Nr. Prot.:
Unit:	Prot. No.:
Jedlnica:	Br. Prot.:
Nr. f faqeve:	Data:
No. of pages:	Datum:
Br. stranica:	Prishtina



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RREGULLORE E PUNËS E KËSHILLIT  
MBIKQYRËS TË OMK-së

Prishtinë,  
DHJETOR 2019

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS** në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 47 paragrafi 6 dhe Neni 56 paragrafet 1 dhe 2 të Statutit të OMK-së, Nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores për Punën e Kuvendit, e miratuar në mbledhjen e datës 22 qershor 2017, e plotësuar dhe ndryshuar në mbledhjen e rregullit të datës 17 dhjetor 2019, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

## **RREGULLORE E PUNËS E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË OMK-SË**

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 25/2019 të Kuvendit të OMK-së, datë 17 dhjetor 2019)

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1.1. Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat, rregullat, kriteret dhe kompetencat e pavarura të Këshillit Mbikqyrës të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe zbatimit të tyre në praktikë (më tutje në tekst Oda e Mjekëve të Kosovës: OMK)

### **Neni 2**

#### **Themelimi dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikqyrës të OMK**

2.1. Oda e Mjekëve të Kosovës përmes punimeve të Kuvendit të saj, themelon Këshillin Mbikqyrës të OMK-së, nga radhët e anëtarëve të tij në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarëve.

2.2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës votohen përmes anëtarëve të Kuvendit të OMK-së, nga radhët e të cilëve zgjidhet Kryetari dhe Nën-Kryetari i Këshillit Mbikqyrës në pajtim me Rregulloren mbi procedurat e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OMK-së.

2.3. Anëtarët e këtij Këshilli nuk mund të jenë edhe anëtar të Këshillave dhe Komisioneve tjera brenda OMK-së.

### Neni 3

#### **Kriteret dhe administrimi i mbajtjes së mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës**

3.1. Mbledhjen e Këshillit e udhëheq Kryetari, në mungesë të Kryetarit, e udhëheq Nënkryetari i Këshillit Mbikëqyrës.

3.2. Nëse ndonjëri nga radhët e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mungon 3 (tre) herë pa arsye në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së, ose në rast të dorëheqjes së anëtarit të Këshillit, atëherë anëtarët tjerë në konsultim me Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës, propozojnë Këshillit Drejtues të OMK-së që përmes Kuvendit të OMK-së, të rishikohet përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, dhe në raste të tilla të zgjidhet anëtari tjetër i Këshillit Mbikëqyrës të OMK-së nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të OMK-së.

3.3. Në mungesë të Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës, me arsye objektive, mbledhjet i mbanë Nënkryetari. Nëse Kryetari i Këshillit Mbikqyrës mungon 3 here në mbledhje pa arsye, atëherë Këshilli e shqyrton çështjen dhe kërkon largimin e Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës nga pozita e Kryetarit, dhe ndjekjen e procedurës sipas ligjit të OMK-së për zgjedhjen e Kryetarit të ri të Këshillit Mbikqyrës.

### Neni 4

#### **E drejta e mbajtjes së mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së**

4.1. Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës të Odës, i fton Kryetari i Këshillit Mbikqyrës, së paku 1 (një) herë në muaj, ndërsa të drejtën për të kërkuar mbajtjen e mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës më shumë se 1 (një) herë në muaj, sipas nevojës dhe problematikës së procesit në mbikqyrjen e proceseve në Odën e Mjekëve të Kosovës e kanë të drejtën edhe 1/3 e anëtarëve tjerë të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së.

## Neni 5

### **Administrimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së**

5.1. Administrimin e materialit për mbledhje të Këshillit Mbikqyrës e pregaditë Kryetari i Këshillit Mbikqyrës në konsultim, koordinim dhe bashkëpunim me Kryetarin e OMK-së dhe shërbimin profesional të OMK-së.

5.2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të OMK-së duhet të informohen për mbledhje së paku 3 (tre) ditë para datës së caktuar të mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës të Odës, njëkohësisht materiali për rendin e ditës t'iu shpërndahet anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës 3 (tre) ditë para mbajtjes së mbledhjes.

5.3. Në çdo mbledhje të Këshillit Mbikqyrës nga Kryesuesi verifikohet pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, ku për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës duhet të ketë kuorum së paku 4 (katër) anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të jenë prezent.

5.4. Për punën e zhvilluar të mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës mbahet procesverbali i cili përgaditet brenda 7 (shtatë) ditë pune nga mbajtja e mbledhjes dhe pastaj iu shpërndahet anëtarëve të Këshillit në mbledhjen e radhës, dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës kanë të drejtën që të japin vërejtjet e veta në procesverbal të mbledhjes së kaluar, dhe pastaj me vërejtje të plotësuar të miratohet nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, si dhe të nënshkruhet nga procesmbajtësi dhe Kryetari i Këshillit Mbikqyrës.

5.5. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës ruhen në arkivin e OMK-së.

5.6. Këshilli Mbikqyrës, është i obliguar që 1 (një) herë në 6 (gjashtë) muaj apo 2 (dy) herë brenda vitit kalendarik të përpiloj raport pune lidhur me punën dhe aktivitetet e Këshillit Mbikqyrës, i cili duhet ta miratoj dhe t'ia paraqes Këshillit Drejtues të OMK-së dhe Kuvendit të OMK-së.

5.7. Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës mund të shtyhet ose ndërpritet në rastet kur nuk ka kuorum, dhe në rastet kur mbledhja nuk mund të kryhet në kohën e planifikuar (zgjatë më shumë se koha e planifikuar).

5.8. Mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës e shtynë dhe e ndërpret Kryetari i Këshillit, në mungesë të tij shtyrjen dhe ndërprerjen e mbledhjes e bënë Nënkryetari i Këshillit Mbikqyrës.

## Neni 6

## **Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të OMK**

- 6.1. Çdo anëtarë duhet të jetë i rregullt në mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës.
- 6.2. Çdo anëtarë ka të drejtë të jetë aktiv në mbikqyrjen e zhvillimeve të OMK-së.
- 6.3. Çdo anëtarë ka të drejtë të ndërhyjë dhe të participojë në përpilimin e Rregulloreve të OMK-së.
- 6.4. Çdo anëtarë ka të drejtë të jetë aktiv në zhvillimin e aktiviteteve të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së.
- 6.5. Çdo anëtarë ka të drejtë të propozoj pikat e rendit të ditës, dhe shqyrtimin e çështjeve të mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës.
- 6.6. Çdo anëtarë ka të drejtë të kërkoj sqarime mbi veprimtarinë e Këshillit Mbikqyrës.
- 6.7. Çdo anëtarë ka të drejtë të jetë aktiv në proceset e përpilimit të raportit të punës të Këshillit Mbikqyrës.

## **Neni 7**

### **Detyrat specifike të Këshillit Mbikqyrës të OMK**

- 7.1. Mbikëqyr dhe përcjell afarizmin financiar të OMK-së.
- 7.2. Mbikëqyr dhe përcjell realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të OMK-së, si dhe çdo vendim të nxjerrë nga organet e OMK-së.
- 7.3. Mbikqyrë dhe përcjellë punën e shërbimit profesional të OMK-së.
- 7.4. Propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson se ka shkelje ligjore dhe të akteve të miratuara nga Kuvendi i Odës.
- 7.5. Këshilli Mbikqyrës i OMK-së për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Odës.
- 7.6. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës bashkëpunojnë me Kryetarin e Këshillit Mbikqyrës, Këshillin Drejtues dhe anëtarët e OMK-së, duke respektuar shkathhtësit e komunikimit dhe etikën mjekësore.

## **Neni 8**

### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

- 8.1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Kuvendi i OMK-së.

8.2.Ndyshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njejtës procedurë së miratimit.

### Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së dhe nënshkrimit nga Kryetari i OMK-së.

Prishtinë,

17 dhjetor 2019

Kryetari i OMK-së

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Sci